

Drejtuar:

**KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË
FAKULTETIT TË ARTEVE TË UNIVERSITET TË TETOVËS
SENATIT TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

REFERATI

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Vizatim, (60700 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Programin studimor - Art figurativ në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës.

Në bazë të konkursit të datës 29.08.2023, të shpallur në gazetën ditore „Koha” dhe „Слободен печат”, si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Vizatim, (60700, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve nr. 20- 143/1 të datës 22.09.2023, formohet Komisioni recenzues në përbërje:

Prof.Mr. Bashkim Mexhiti (kryetar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Prof.Mr. Nevzat Bejtuli (anëtar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Prof.Mr. Reshat Ameti (anëtar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 172 të Ligjit për Arsim të Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018” dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021”), Statutine Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve dhe Senatit të Universitetit të Tetovës këtë:

R A P O R T

Në konkursin e datës 29.08.2023, të shpallur në gazetata ditore „Koha” dhe „Слободен печат”, si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Vizatim, (60700, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës, ka konkuruar kandidati/ja e vetëm prof.doc. Drenusha Palloshi.

Kandidati/ja prof.doc. Drenusha Palloshi, nga Tetova, e lindur më 05.11.1989 shtetase e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me numër aplikimi 01 të datës 01.09.2023 ka dorëzuar këto dokumente:

- Diplomë për kryerjen e studimeve akademike (noterizuar)
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës (noterizuar)
- Vendim për njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë të fituar jashtë shtetit (noterizuar)
- Vendim për thirrje mësimore-shkencore profesor docent (noterizuar)
- Listën e aktiviteteve profesionale-artistike dhe aplikative prej zgjedhjes së fundit në thirrje
- Biografinë ku mund të konstatohet kontinuiteti i studimeve dhe aktivitetet permanente profesionale artistike
- Punimin e magjistraturës
- Certifikatë për njohjen e gjuhës angleze
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve
- Certifikatë e shtetësisë
- Fletaplikim nga Universiteti i Tetovës
- Kopje të katalogjeve nga ekspozita të realizuara në vend dhe jashtë vendit, vendimeve, shpërblimeve, mirënjohje, certifikatave.

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin, titullit të lartëpërmendur ia paraqet këtë përshkrim:

Të dhëna biografike të kandidatit

Kandidati/ja prof.doc. Drenusha Palloshi ka lindur më 5.11.1989 në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollimin fillor e kreu në shkollën fillore "Naim Frashëri", Tetovë. Shkollimin e mesëm e kreu në shkollën e mesme shtetërore të muzikës "Todor Skalovski-Tetoeç", Tetovë. Studimet i mbaroi në Universitetin Shtetërorë të Tetovës, në fakultetin e Artit figurativ, e diplomuar në vitin 2013 drejtimin pedagogjik dega pikturë me temën "Tinguj akordesh në pikturë, me mentor profesorin Ilirjan Beqiri, ndërsa magjistraturën e kreu në vitin 2015 në drejtimin pikturë me mentor profesorin Reshat Ameti me temën "Reminishencat muzikore në pikturë".

Kandidati/ja prof.doc. Drenusha Palloshi përveç arsimit formal ka ndjekur edhe seminare dhe trajnime të ndryshme në të cilat ka përfituar shkathtësi plotësuese profesionale.

Sa i përket krijimtarisë artistike figurative kandidatja ka realizuar disa ekspozita personale si dhe ka marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive dhe simpoziume (koloni) artistike si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Për krijimtarinë dhe aktivitetin e saj artistik është shpërblyer me disa çmime në manifestime të ndryshme artistike. Kandidatja prof.doc. Drenusha Palloshi është anëtare aktive e Shoqatës së Artistëve Figurativ të Qytetit të Tetovës.

VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE

Kandidati/ja prof.doc. Drenusha Palloshi

Ne vitin 2015 u angazhua si asistente part time në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës, më pas në vitin 2018 mori titullin akademik shkencorë docent..

Përvoja pedagogjike dhe universitare

Kandidati/ja prof.doc. Drenusha Palloshi veprimtarinë edukative-arsimore e ka filluar në vitin në vitin 2015 me angazhimin e saj si asistente part-time në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës - programi studimor Arti Figurativ, për lëndën mësimore Vizatim 1,2,3 dhe 4. Në vitin 2018 zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **docent** për lëndët profesionale artistike Vizatim dhe Vizatim me pikturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës, Programi studimor Arti figurativ, vendimi nr. 04-5480/1 të datës, 21.12.2018.

Mbajtja e mësimit nga cikli i parë i studimeve

Vizatim 1,2	2022/2023	4x15x2x0.04
Anatomi plastike 1,2	2022/2023	1x15x2x0.04
Vizatim 3,4	2021/2022	4x15x2x0.04
Anatomi plastike 1,2	2021/2022	1x15x2x0.04
Vizatim 3,4	2020/2021	4x15x2x0.04
Anatomi plastike 1,2	2020/2021	1x15x2x0.04
Vizatim 3,4	2019/2020	4x15x2x0.04
Anatomi plastike 1,2	2019/2020	1x15x2x0.04
Vizatim 3,4	2018/2019	4x15x2x0.04
Anatomi plastike 1,2	2018/2019	1x15x2x0.04

Mbajtja e ushtrimeve nga cikli i parë i studimeve

Vizatim 1,2	2022/2023	4x15x2x0.03
Anatomi plastike 1,2	2022/2023	1x15x2x0.03

Vizatim 3,4	2021/2022	4x15x2x0.03
Anatomi plastike 1,2	2021/2022	1x15x2x0.03
Vizatim 3,4	2020/2021	4x15x2x0.03
Anatomi plastike 1,2	2020/2021	1x15x2x0.03
Vizatim 3,4	2019/2020	4x15x2x0.03
Anatomi plastike 1,2	2019/2020	1x15x2x0.03
Vizatim 3,4	2018/2019	4x15x2x0.03
Anatomi plastike 1,2	2018/2019	1x15x2x0.03

Konsultime me studentë

Vizatim 1,2 / Anatomi plastike 1,2	2022/2023	22x2x0.002
Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2	2021/2022	22x2x0.002
Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2	2020/2021	22x2x0.002
Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2	2019/2020	22x2x0.002
Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2	2018/2019	22x2x0.002

Anëtar i komisionit për vlerësimin ose mbrojtjen e punimit të diplomës

Anëtar i komisionit	2021-2023	5x0.1
---------------------	-----------	-------

Përvoja profesionale

- Anëtare e këshillit mësimes-shkencor në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Tetovës, nga viti 2019.
- Ditët e hapura të UT-së, prezantim i programeve studimore të Fakultetit të Arteve, gjatë periudhës 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023.

Prezantim publik i pavarur me vepra të artit figurativ

- 2022 – GN „Stacioni vogel’’, Shkup.
- 2022 - QIK e RMV, Stamboll, Turqi.
- 2021 – IN Galeria e Arteve Tetovë, Tetovë
- 2018 – QIK, Shkup

Prezantim publik grupor me vepra të artit figurativ - me projekt të veçantë ndërkombëtar, në manifestim me regji të përzgjedhur (në botën e jashtme)

- 2023 - Ekspozitë grupore „Sinestezi’’ - Performancë, QIK e RMV, Stamboll, Turqi.

Prezantim publik grupor me vepra të artit figurativ - me projekt të veçantë, në manifestim me përzgjedhje dhe regji (në vendin tonë)

- 2023 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve, Tetovë.
- 2023 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë
- 2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve Tetovë.
- 2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të Simpoziumit Internacional „Struga 2022’’, Strugë.
- 2022 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit’’, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.
- 2022 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë
- 2021 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë.
- 2021 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit’’, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.
- 2021 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike „Art kamp 2021’’, Likovë
- 2020 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë
- 2020 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë.
- 2018 - Ekspozita e pjesëmarësve „550 Viti i Skënderbeut’’, Universiteti i Tetovës.

- 2018 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë
- 2018 – Ekspozita grupore „Hyjneshat’’, IN Galeria eArteve, Tetovë.

Pjesëmarrje në aktivitete promovimi të fakultetit

- Ditët e hapura të UT-së, prezantim i programeve studimore të Fakultetit të Arteve, gjatë periudhës 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023.

Publikim i veprës artistike në katalogun e manifestimit nacional të artit figurativ

- 2023 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve, Tetovë.
- 2023 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë
- 2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve Tetovë.
- 2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të Simpoziumit Internacional „Struga 2022’’, Strugë.
- 2022 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit’’, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.
- 2022 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë
- 2021 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë.
- 2021 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit’’, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.
- 2021 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike „Art kamp 2021’’, Likovë
- 2020 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë
- 2020 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë.
- 2018 - Ekspozita e e pjesëmarësve „550 Viti i Skënderbeut’’, Universiteti i Tetovës.
- 2018 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria e Arteve, Tetovë
- 2018 – Ekspozita grupore „Hyjneshat’’, IN Galeria eArteve, Tetovë.

Publikim i veprës artistike në katalogun e manifestimit ndërkombëtar të artit figurativ

- 2023 - Ekspozitë grupore „Sinestezi’’ - Performancë, QIK e RMV, Stamboll, Turqi

Pjesëmarrje në simpoziume ndërkombëtare të artit figurativ (koloni)

- 2023 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve, Tetovë.
- 2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve Tetovë.
- 2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të Simpoziumit Internacional „Struga 2022’’, Strugë
- 2021 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike „Art kamp 2021’’, Likovë

VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Anëtar i komisionit të fakultetit

- Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20 -11/5 të datës 15.02.2023
- Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20-349/5 të datës 22.12.2022
- Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20-264/5 të datës 09.11.2021
- Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20 -72/5 të datës 08.04.2021
- Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20 -31/5 të datës 19.02.2021

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikë
VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE	53.44
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ARTISTIKE DHE ZBATUESE	79.00
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	2.5
Gjithsej	134.94

PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, duke vlerësuar pozitivisht aktivitetin në veprimtarinë edukative-mësimore, profesionale-artistike dhe zbatuese, veprimtarinë me interes më të gjerë, kontinuitetin në studime, përvojën pedagogjike dhe universitare prej zgjedhjes në thirrjen asistent, docent në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës dhe sipas Ligjit për Arsim të Lartë, Statutit të Universitetit të Tetovës dhe Rregullores për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në tituj mësimorë - shkencorë, shkencorë mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, Komisioni recensues vlerëson se kandidati/ja **prof.doc. Drenusha Palloshi** i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-profesionale **Profesor Inordinar**.

Komisioni Recensues ka nderin t'i propozoj Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve dhe Senatit të Universitetit të Tetovës, që kandidati/ja **prof.doc. Drenusha Palloshi** të zgjidhet në thirrjen mësimore-profesionale **Profesor Inordinar** në lëmin **Vizatim, (60700, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës.

Anëtarët e komisionit:

Prof.Mr. Bashkim Mexhiti (kryetar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Prof.Mr. Nevzat Bejtuli (anëtar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Prof.Mr. Reshat Ameti (anëtar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Tetovë, 09.11.2023

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMOR-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati/ja:

Drenusha Palloshi

Institucioni:

Fakulteti i Arteve, Universiteti i Tetovës

Lëmia shkencore:

**Vizatim (60700, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjvëshkencorë-hulumtues sipas
Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË - DOCENT, PROFESOR I ASOCIUAR DHE PROFESOR ORDINAR NË LËNDËT PROFESIONALE ARTISTIKE

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Studime pasdiplomike të kryera dhe shkalla e aritur akademike: Magjistër i arteve figurative nga lëmia e pikturës. Sfera shkencore: Shkencat humane (6), Fusha shkencore: Arti figurativ (607), Lëmia shkencore: Vizatim (60700, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit),	po
3	Posedon aftësi për realizimin e punës mësimore 1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e punës mësimore: Fakulteti i Arteve, Universiteti i Tetovës 2. Lloji i trajnimit/ përvojës/ arsimimit për përfitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e punës mësimore: Asistent, docent 3. Periudha e fitimit të aftësive dhe shkathtësive për realizimin e punës mësimore: 2015–2023	po

FORMULARI 2**PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL**

Kandidati/ja:

Drenusha Palloshi

Institucioni:

Fakulteti i Arteve, Universiteti i Tetovës

Lëmia shkencore:

Vizatim (60700 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjvëshkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE**

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Mbajtja e mësimit nga cikli i parë i studimeve	30
1.1	Vizatim 1,2 2022/2023	4x15x2x0.04=4.8
1.2	Anatomi plastike 1,2 2022/2023	1x15x2x0.04=1.2
1.3	Vizatim 1,2 2021/2022	4x15x2x0.04=4.8
1.4	Anatomi plastike 1,2 2021/2022	1x15x2x0.04=1.2
1.5	Vizatim 1,2 2020/2021	4x15x2x0.04=4.8
1.6	Anatomi plastike 1,2 2020/2021	1x15x2x0.04=1.2
1.7	Vizatim 1,2 2019/2020	4x15x2x0.04=4.8
1.8	Anatomi plastike 1,2 2019/2020	1x15x2x0.04=1.2
1.9	Vizatim 1,2 2018/2019	4x15x2x0.04=4.8
1.10	Anatomi plastike 1,2 2018/2019	1x15x2x0.04=1.2
2	Mbajtja e ushtrimeve nga cikli i parë i studimeve	22.5
2.1	Vizatim 1,2 2022/2023	4x15x2x0.03=3.6
2.2	Anatomi plastike 1,2 2022/2023	1x15x2x0.03=0.9
2.3	Vizatim 1,2 2021/2022	4x15x2x0.03=3.6
2.4	Anatomi plastike 1,2 2021/2022	1x15x2x0.03=0.9
2.5	Vizatim 1,2 2020/2021	4x15x2x0.03=3.6
2.6	Anatomi plastike 1,2 2020/2021	1x15x2x0.03=0.9
2.7	Vizatim 1,2 2019/2020	4x15x2x0.03=3.6
2.8	Anatomi plastike 1,2 2019/2020	1x15x2x0.03=0.9
2.9	Vizatim 1,2 2018/2019	4x15x2x0.03=3.6
2.10	Anatomi plastike 1,2 2018/2019	1x15x2x0.03=0.9
3	Konsultime me studentë	0.44
3.1	Vizatim 1,2 / Anatomi plastike 1,2 2022/2023	22x2x0.002=0.088
3.2	Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2 2021/2022	22x2x0.002=0.088
3.3	Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2 2020/2021	22x2x0.002=0.088
3.4	Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2 2019/2020	22x2x0.002=0.088
3.5	Vizatim 3,4 / Anatomi plastike 1,2 2018/2019	22x2x0.002=0.088
4	Anëtar i komisionit për vlerësimin ose mbrojtjen e punimit të diplomës	0.5
4.1	Anëtare e komisionit 2021-2023	5x0.1=0.5
	Gjithsej	53.44

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ARTISTIKE DHE ZBATUESE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Prezantim publik i pavarur me vepra të artit figurativ në vendin tonë	
1.1	2022 – GN „Stacioni vogel’’, Shkup.	5
1.2	2021 – IN Galeria e Arteve Tetovë, Tetovë	5
1.3	2018 – Qendra Informative Kulturore, Shkup.	5
2	Prezantim publik grupor me vepra të artit figurativ - me projekt të veçantë ndërkombëtar, në manifestim me regji të përzgjedhur (në botën e jashtme)	
2.1	2022 - QIK e RMV, Stamboll, Turqi	4
3	Prezantim publik grupor me vepra të artit figurativ - me projekt të veçantë, në manifestim me përzgjedhje dhe regji (në vendin tonë)	
3.1	2023 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve, Tetovë.	2
3.2	2023 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	2
3.3	2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve Tetovë.	2
3.4	2022 - Ekspozita e pjesëmarësve të Simpoziumit Internacional „Struga 2022’’, Strugë.	2
3.5	2022 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit’’, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.	2
3.6	2022 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	2
3.7	2021 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë.	2
3.8	2021 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit’’, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.	2
3.9	2021 - Ekspozita e pjesëmarësve të kolonisë artistike „Art kamp 2021’’, Likovë	2
3.10	2020 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	2
3.11	2020 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë.	2
3.12	2018 - Ekspozita e e pjesëmarësve „550 Viti i Skënderbeut’’, Universiteti i Tetovës.	2
3.13	2018 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	2
3.14	2018 – Ekspozita grupore „Hyjneshat’’, IN Galeria eArteve, Tetovë.	2

4	Pjesëmarrje në aktivitete promovimi të fakultetit	
4.1	Ditët e hapura të UT-së, prezantim i programeve studimore të Fakultetit të Arteve, gjatë periudhës 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023.	3
5	Publikim i veprës artistike në katalogun e manifestimit nacional të artit figurativ	
5.1	2023 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	1
5.2	2023 - Ekspozita e pjesëmarrësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve, Tetovë	1
5.3	2022 - Ekspozita e pjesëmarrësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve Tetovë.	1
5.4	2022 - Ekspozita e pjesëmarrësve të Simpoziumit Internacional „Struga 2022”, Strugë.	1
5.5	2022 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit”, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.	1
5.6	2022 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	1
5.7	2021 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë.	1
5.8	2021 - Ekspozitë mbarëkombëtare „Çmimi i Nëntorit”, Draudacum, IN Qendra për Kulturë, Gostivar.	1
5.9	2021 - Ekspozita e pjesëmarrësve të kolonisë artistike „Art kamp 2021”, Likovë	1
5.10	2020 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	1
5.11	2020 - Saloni pranveror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë.	1
5.12	2018 - Ekspozita e e pjesëmarrësve „550 Viti i Skënderbeut”, Universiteti i Tetovës.	1
5.13	2018 – Ekspozita grupore „Hyjneshat”, IN Galeria eArteve, Tetovë	1
5.14	2018 - Saloni dimëror, Ekspozita e Shoqatës së Artistëve Figurativ të qytetit të Tetovës, IN Galeria eArteve, Tetovë	1
6	Publikim i veprës artistike në katalogun e manifestimit ndërkombëtar të artit figurativ	
6.1	2022 - QIK e RMV, Stamboll, Turqi	2
6.2	Pjesëmarrje në simpoziume ndërkombëtare të artit figurativ (koloni)	
6.3	2023 - Ekspozita e pjesëmarrësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve, Tetovë.	4
6.4	2022 - Ekspozita e pjesëmarrësve të kolonisë artistike, IN Galeria e Arteve Tetovë.	4
6.5	2022 - Ekspozita e pjesëmarrësve të Simpoziumit Internacional „Struga 2022”, Strugë	4
6.6	2021 - Ekspozita e pjesëmarrësve të kolonisë artistike „Art kamp 2021”, Likovë	4
	Gjithsej	79

VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Anëtar i komisionit të fakultetit	
1.1	Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20 -11/5 të datës 15.02.2023	0.5
1.2	Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20-349/5 të datës 22.12.2022	0.5
1.3	Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20-264/5 të datës 09.11.2021	0.5
1.4	Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20 -72/5 të datës 08.04.2021	0.5
1.5	Anëtare e komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, vendimi nr.20 -31/5 të datës 19.02.2021	0.5
	Gjithsej	2.5

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikë
VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE	53.44
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ARTISTIKE DHE ZBATUESE	79
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	2.5
Gjithsej	134.94

Anëtarët e komisionit:

Prof.Mr. Bashkim Mexhiti (kryetar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Prof.Mr. Nevzat Bejtuli (anëtar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Prof.Mr. Reshat Ameti (anëtar)

profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Drejtuar:

**KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT TË
ARTEVE TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

REFERAT

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin-Arti i hershëm krishterë, Arti mesjetar perëndimor, Arti mesjetar bizantin, Arti mesjetar kombëtar, Arti i Rilindjes i përgjithshëm, Arti i Rilindjes kombëtare, Arti barok i përgjithshëm, Arti barok kombëtar (60600, 60601, 60602, 60603, 60605, 60606, 60607, 60608, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Programin studimor - Arti figurativ në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Në bazë të konkursit të datës 29.08.2023, të shpallur në gazetata ditore „Koha” dhe „Слободен печат”, si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Arti i hershëm krishterë, Arti mesjetar perëndimor, Arti mesjetar bizantin, Arti mesjetar kombëtar, Arti i Rilindjes i përgjithshëm, Arti i Rilindjes kombëtare, Arti barok i përgjithshëm, Arti barok kombëtar (60600, 60601, 60602, 60603, 60605, 60606, 60607, 60608, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)** në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve me nr. 20-143/1 të datës 22.09.2023, u formua Komisioni recensues në përbërje:

1. Dr. Mixhait Pollozhani, profesor ordinar në Fakultetin e Arteve, pranë Universitetit të Tetovës - **(kryetar)**
2. Dr. Xhemil Bektoviç, profesor ordinar në Fakultetin e Arteve dhe Dizajnit në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik (IBU) - **(anëtar)**
3. Dr. Metin Izeti, profesor ordinar në Fakultetin e Arteve, pranë Universitetit të Tetovës - **(anëtar)**

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 171 dhe 172 të Ligjit për Arsim të Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018” dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/20218 me nenin 251 të Statutit e Universitetit të Tetovës, si dhe me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve dhe Senatit të Universitetit të Tetovës këtë:

RAPORT

Në konkursin e shpallur më datë 29.08.2023, në gazetata ditore „Koha” dhe „Слободен печат”, si dhe në web-faqen e Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen - *profesor inordinar* në lëmin: **Arti i hershëm krishterë, Arti mesjetar perëndimor, Arti mesjetar bizantin, Arti mesjetar kombëtar, Arti i Rilindjes i përgjithshëm, Arti i Rilindjes kombëtare, Arti barok i përgjithshëm, Arti barok kombëtar (60600, 60601, 60602,60603, 60605, 60606, 60607, 60608, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)** në Fakultetin e Arteve pranë Universitetit të Tetovës, u paraqit vetëm kandidati, Doc. Dr. Jëlldëz Asani

Dokumentet e dorëzuara

- Diplomë për kryerjen e studimeve akademike (noterizuar)
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës (noterizuar)
- Diplomë për kryerjen e studimeve të doktoraturës (noterizuar)
- Vendim për thirrje mësimore-shkencore docent (noterizuar)
- Listën e aktiviteteve profesionale-artistike dhe aplikative prej zgjedhjes së fundit në thirrje
- Biografinë ku mund të konstatohet kontinuiteti i studimeve dhe i aktiviteteve permanente profesionale artistike
- Punimin e doktoranturës
- Çertifikatë për njohjen e gjuhës së angleze
- Çertifikatë nga libri amë i të lindurve
- Çertifikatë të shtetësisë
- Fletaplikim nga Universiteti i Tetovës
- Kopje të artikujve dhe librave shkencor të publikuara brenda dhe jashtë vendit

II. BIOGRAFI E SHKURTËR

a. Arsimimi

Nga dokumentacioni i parashtruar u konstatua se, Doc. Dr. Jëlldëz Asani është e lindur më 11.04.1979 në Tetovë. Në vitin shkollor 1996/97 e kreu shkollën e mesme të gjimnazit “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë. Studimet i kreu në fakultetin Filozofik, katedrën e Historisë së Artit dhe Arkeologjisë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup, ku u diplomua në vitin akademik 2001/2002. Studimet pasuniversitare i kreu në vitin 2010 në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup. Teza magjistraturës me titull: “*Krijimtaria e piktorëve shqiptar në dy dekadat e fundit të shekullit XX në Maqedoni dhe Kosovë*”, mentor Dr. Vlladimir Veliçkovski, duke marrë titullin – Magjistër i Historisë së Artit. Në këtë punë të rëndësishme shkencore, autorja ka trajtuar temat dhe motivet në pikturat e autorëve të ndryshëm në mënyrë profesionale duke i prezantuar kryeveprat e tyre me reproduksione. Këtë punim autorja e ka botuar në formë të librit të cilën e shfrytëzojnë si literaturë studentët e artit figurativ.

Në maj të vitit 2017 ka mbrojtur me sukses doktoraturën me temë “*Piktura bashkëkohore shqiptare në Ballkan*” në Universitetin Internacional të Novi Pazarit, dhe ka marrë titullin Doktor i Historisë së artit. Ky punim (akoma i pa publikuar) paraqet veprën e vetme shkencore kushtuar kësaj problematike specifike të artit figurativ dhe të historisë së artit modern. Janë bërë hulumtime të gjera të veprave karakteristike dhe relevante figurative, si dhe të materialeve të shkruara mbi këtë problematikë, duke shkoqitur elementet dhe përfundimet thelbësore. Punimi përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe pjesa kryesore, të cilët pastaj janë ndarë në më shumë kapituj dhe nënkapituj ku i trajton faktorët historik, filozofik, politik, karakteristikat vizuale dhe estetike, të cilat ndihmuan në formimin konceptual të pikturës bashkëkohore shqiptare në Ballkan.

b. Aktiviteti akademik

Kandidatja, Doc. Dr. **Jëlldëz Asani** nga viti shkollor 2006/7 është e punësuar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, asistent dhe pastaj ligjëruese e lëndëve Historia e Artit në Fakultetin e Arteve. Në vitin shkollor 2012/2013 me vendim të Këshillit mësimor – shkencor të FA dhe Këshillit të Rektoratit të USHT – së, Mr. Jëlldëz Asani u zgjodh asistent në Fakultetin e Arteve pranë USHT – së në fushën e historisë së artit. Me vendim të Këshillit mësimor – shkencor të FA dhe Këshillit të Rektoratit të USHT – së, kandidati dr. Jëlldëz Asani në vitin 2019 është zgjedhur në thirrjen mësimore *docent* në Fakultetin Arteve të Universitetit Shtetëror të Tetovës, për lëndën Historia e artit I, II, III dhe IV në Programin studimor të Arti figurativ. Që nga

momenti i zgjedhjes në titullin akademik – *docent*, kandidatja Jëlldëz Asani, rregullisht ligjëron në të dy semestrat të çdo viti shkollor, në ciklin e parë të Fakultetit të Arteve.

Aktiviteti mësimor i Doc. Dr. Jëlldëz Asanit, krahas në fakultetin amë vazhdon si viziting profesor në Fakultetin e Arteve të Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë që nga viti 2019.

Më 12.02.2019 është zgjedhur prodekane për shkencë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës, ndërsa më 02.03.2023 është zgjedhur prodekane për arsim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës.

c. Aktivitet tjera

Doc. Dr. Jëlldëz Asani duke pasur parasysh se ka kryer studimet në degën e Historisë së artit dhe arkeologjisë, ajo ka qenë e angazhuar si arkeologe në Qendrën Nacionale për Konservim të Trashëgimisë Kulturore gjatë viteve 2005-2007. Gjithashtu ka marrë pjesë në gërmime të shumta arkeologjike si në lokalitetin Stobi, lokalitetin Kalaja e Shkupit dhe lokalitetin Kalaja e Tetovës. Në vitin 2014 pajiset me diplomë të çertifikuar nga Shkolla e Protokollit të Washingtonit, e cila është lider në industrinë e protokollit në SHBA, për pjesëmarrje në trajnim për protokoll dhe etikë profesionale në Akademinë e Protokollit në Shkup.

Nga viti 2011 Doc. Dr. Jëlldëz Asani është kryetare e këshillit drejtues të Institutit Nacional Galeria e Arteve Pamore në Tetovë.

Nga viti 2016-2022 ka qenë koordinatore e projektit “Ura me tri harqe” në bashkëpunim me Universitetin e Tetovës, Universitetin e Arteve të Tiranës dhe me Fakultetin e Arteve të Universitetit Hasan Prishtina në Prishtinë.

